

## **VERSIONI PUNUES**

### **REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,  
Miraton:

#### **LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-051 PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TE INTERESIT NE USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK**

##### **Neni 1**

Në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (më tej ligji), në nenin 1 pas fjalëve “zyrtarë të lartë” shtohet fjala “publik”, ndërsa në tërë tekstin e ligjit fjalët “zyrtari i lartë” zavendësohet me fjalën “zyrtar i lartë publik”.

##### **Neni 2**

Në nenin 4 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, pas fjalës “Kryeshefat e Agjencive” shtohen fjalët “apo pozitat e barazvlefshme” si dhe pas fjalës “tjetër” shtohen fjalët “dhe zëvendësit e tyre”.

Në nenin 4 të ligjit, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.10 fshihen fjalët “Kryesuesit, Zëvendës-Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale”.

Në nenin 4 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13, ndryshohet si vijon: “Drejtorët apo Udhëheqësit apo menaxheret e të gjitha Departamenteve, Drejtorive apo Drejtorateve, Udhëheqësit e Financave dhe Prokurimit publik në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet publike”.

Në nenin 4 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.15, pas fjalëve “prorektorët e Universiteteve Publike” shtohen fjalët “anëtarët e Këshillit Drejtues të Universiteteve Publike”.

Në nenin 4 të ligjit, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20, pas fjalës “kryeinspektorët” shtohen fjalët “dhe zëvendës kryeinspektorët”.

Në nenin 4 të ligjit, pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri si në vijim: 3. “Të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryeministri si dhe Ministrat, e që nuk përmendën shprehimisht me këtë ligj.”

##### **Neni 3**

Në nenin 8 të ligjit, paragrafi 4 fshihet ndërsa paragrafi 5 bëhet paragrafi 4 dhe paragrafi 6 bëhet paragrafi 5.

#### **Neni 4**

Në nenin 9 të ligjit, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 pas fjalës “shpërblim” shtohet fjalët “apo favore”.

Në nenin 9 të ligjit, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6 pas fjalës “punëve” shtohet fjala “shërbimeve”.

Në nenin 9 të ligjit, paragrafi 1, pas fjalëve të fundit të nën-paragrafit 1.7, 1.8, 1.9, shtohen fjalët: “bashkë-aksionarë apo në lidhje të mëhershme afariste”.

#### **Neni 5**

Në nenin 12 të ligjit, në paragrafi 2 fjala “deri” fshihet.

#### **Neni 6**

Në nenin 14 të ligjit, paragrafi 2 pas fjalëve “në afat prej” fjalët “tridhjetë (30)” zëvendësohet me fjalën “pesëmbëdhjetë (15)”.

Në nenin 14 të ligjit, paragrafi 4 pas fjalës “besuar” shtohen fjalët “apo i afërm”.

#### **Neni 7**

Në nenin 15 të ligjit, paragrafi 2 fshihet, ndërsa paragrafi 3 rinumërohet si paragraf 2 dhe vazhdon rinumërimi deri në fund të këtij neni.

Në nenin 15 të ligjit, paragrafi 5 pas fjalës “besuar” shtohen fjalët “apo i afërm”.

#### **Neni 8**

Në nenin 16 të ligjit, paragrafi 1, pas fjalës “menaxhuese” shtohen fjalët “apo kontrolluese”.

Në nenin 16 të ligjit, paragrafi 2, pas fjalës “noterisë” shtohet fjalët “përmbaruesit privat”.

#### **Neni 9**

Në nenin 18 të ligjit, paragrafi 1 fjalët “me kërkesën e zyrtarit të lartë dhe pas aprovimit nga udhëheqësi i tij fshihet”.

Në nenin 18 të ligjit, paragrafet 11, fjalët “brenda afatit të pacaktuar” fshihen.

## **Neni 10**

Në nenin 19 të ligjit, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, fshihen fjalët “dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave;”.

Në nenin 19 të ligjit, paragrafi 1, pas nën-paragrafit 1.6, shtohen dy paragrafët si në vijim:

“1.7. Agjencia ka të drejtë të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit në të gjitha aktivitetet e prokurimit publik”;

“1.8. me qëllim të evitimit të mangësive të konstatuara në procedurat e prokurimit publik, Agjencia ofron rekomandime për titullarët e institucioneve.”.

## **Neni 11**

Neni 20 ndryshohet si vijon:

1. Agjencia ushtron kallëzim penal në prokurorinë kompetente ndaj zyrtarit të lartë publik i cili shkel detyrimet e parapara me këtë ligj, e që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
2. Çdo shkelje e detyrimeve të percaktuara në këtë ligj e që nuk përbën vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Agjencia fillon procedurë tjetër në pajtim me ligjin.
3. Për inicimin e procedurës përkatëse, Agjencia e njofton udhëheqësin e institucionit në të cilin zyrtari i lartë publik punon apo ka punuar.

## **Neni 12** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.